



USAID

NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

STREETLAW INC



FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION



AKADEMIA PËR UDHËHEQËSI NË KOMUNITET – EDICIONI NË PRIZREN

THIRRJE PËR TË GJITHË TË RINJTË DHE TË REJAT E MOSHËS 18-24 VJEÇ

Bëhu pjesë e Akademisë për Udhëheqësi në Komunitet, program gjashtë javor i cili iu përgatitë për t'u organizuar dhe angazhuar për ndryshime pozitive në komunitetin tuaj.

Programi i Akademisë ofron trajnim dhe përgatitje profesionale përmes punëtorive, takimeve dhe punës praktike që iu mundësojnë të zhvilloni aftësitë për organizim dhe zbatim të nismave në komunitet, si dhe të ndërtoni rrjet me aktivistë e profesionistë të tjerë. Është një eksperiencë e veçantë që zhvillohet nga trajnerë me njohuri dhe përvojë të dëshmuar.

KU DHE KUR DO MBAHET AKADEMIJA?

Kohorta e katërt e Akademisë do të mbahet në Prizren dhe do të zgjasë gjashtë javë, nga nëntori deri në dhjetor të vitit 2024.

KUSH MUND TË APLIKOJË?

Të gjithë të rinjtë dhe të rejtat e moshës 18-24 vjeç nga Kosova janë të ftuar të aplikojnë në këtë mundësi transformuese. Duke pasur parasysh vendin se ku do të mbahet Akademia, përparësi do të kenë aplikantët të cilët vijnë nga rajoni i Prizrenit (komuna e Suharekës, komuna e Malishevës, komuna e Dragashit dhe komuna e Mamushës).

Programi i dedikohet të rinjve që dëshirojnë të zgjerojnë njohuri dhe aftësi për të kontribuar në përmirësimin e komunitetit të tyre, qoftë në shkollë, lagje apo organizata lokale. Aplikantët e interesuar duhet të jenë të gatshëm dhe të motivuar për të marrë pjesë dhe për të përfunduar programin e Akademisë, duke përfituar gjithashtu nga mundësitë që ofrohen pas përfundimit të saj.

KCSF njëherazi inkurajon gjithëpërfshirje nga aspekti gjinor dhe etnik.

SI MUND TË APLIKOJ?

Për të pasur mundësinë të jeni një nga 25 pjesëmarrësit e përzgjedhur që do të filloni një udhëtim të ri në mësim dhe aktivizëm komunitar, ju duhet të plotësoni **FORMËN PËR APLIKIM**.

Aplikimet do të pranohen deri më **6 tetor 2024, në ora 23:59**.

- Programi i detajuar i Akademisë do të shpërndalet me pjesëmarrësit pas përzgjedhjes.

PËRSE TË APLIKOJ?

Pas përfundimit të Akademisë, do të jeni të pajisur me njohuri mbi parimet themelore të demokracisë dhe zhvillimin demokratik në Kosovë, duke përfshirë dobësitë, sfidat dhe mundësitë për zhvillim të mëtejshëm, si dhe rolin e qytetarëve në ruajtjen dhe forcimin e demokracisë.

Do të jeni të përgatitur rreth udhëheqësisë dhe aktivizimit, duke përfshirë aftësitë e mendimit kritik, hulumtimit, komunikimit, si dhe zgjerimin e rrjetit tuaj të përkrahësve dhe komunitetit. Do të mësoni si të konceptoni dhe të shkruani një nismë për të adresuar një çështje ose nevojë në komunitetin tuaj, duke rritur kështu besimin tuaj në aftësitë për të sjellë ndryshime pozitive në shoqëri.

Pas përfundimit të programit, do pajiseni me certifikatë, do të zhvilloni dhe zbatoni ide origjinale për zbatimin e një nisme në komunitetin tuaj.

RRETH PROGRAMIT PËR ANGAZHIM QYTETAR:

Programi për Angazhim Qytetar është iniciativë pesë vjeçare që zbatohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Qëllimi i këtij partneriteti është të ushqejë kulturën e aktivizmit që e bën jetën në lagjet dhe qytetet tona më të mirë, më të kujdesshme dhe më kuptimplotë. Nëpërmjet aktiviteteve të tij, programi do të realizojë një numër të veprimeve të bazuara në tre shtylla thelbësore: angazhimin e komunitetit, rritjen e besimit ndër-shoqëror, si dhe zgjerimin e mobilizimit dhe burimeve të reja.

Na kontaktoni:

Nëse ju duhen më shumë informata, ju lutem na kontaktoni në adresën elektronike aplikimi@kcsfoundation.org, apo në rrjetet tona sociale në:



<https://www.facebook.com/KCSFoundation>



https://www.instagram.com/kcsf_foundation/



<https://www.linkedin.com/company/kosovar-civil-society-foundation-kcsf/>



<https://x.com/KCSFoundation>